



BASHKIA MALËSI E MADHE

**PROJEKT- PAKETA
FISKALE 2021**

PROFILI I BASHKISË

Bashkia Malësi e Madhe është njësi me shtrirje të gjërë territoriale në pjesën veri-përendimore të territorit të Republikës së Shqipërisë, ku kufizohet me Malin e Zi në pjesën përendimore dhe veriore dhe me Bashkinë e Shkodrës në pjesën jugore dhe lindore.

Aktualisht sipas reformës së re administrativo-territoriale, Bashkia Malësi e Madhe përbëhet nga 6 Njësi Administrative, të cilat janë: Koplik, Gruemirë, Qendër, Kastrat, Shkrel, Kelmend, ku qendra e bashkisë është qyteti Koplikut.

Popullsia e Bashkisë Malësi e Madhe është afërsisht **55,584** banorë (sipas të dhënave të Zyrës së Gjëndjes Civile). Sipas Ligjit nr 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, në total në të gjithë territorin e Bashkisë numërohen 2 qytete dhe 56 fshatra. Në tabelën me poshtë jepen të dhëna më të detajuara:

BASHKIA MALËSI E MADHE		
NJ.A	Popullsia	Qytet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Koplik	9585	Qyteti Koplik.
Gruemirë	14417	Fshtrat: Gruemirë, Boriç i vogël, Grudë-Fushë, Grilë, Kurtë, Linaj-egç-Lepurosh, Omaraj, Rrash, Vorfë, Demiraj, Ktosh, Gjormë, Mshqerrë, Vajush, Boriç i Madh, Kerraj.
Qendër	6900	Fshtrat: Bogiq- Palvar, Dobër, Jubicë, Kamicë-Flakë, Kalldrun, Koplik i Sipërm, Stërbeq, Lohe e Poshtme.
Shkrel	6058	Fshtrat: Dedaj, Bogë, Bzhetë, Bzhetë-Markaj, Lohe e Sipërme, Vrith, Vuç-Kurtaj, Zagorë, Qaf-Gradë, Reç, Rrepisht, Kokpapaj.
Kastrat	12489	Qyteti Bajzë, Fshtrat: Ivanaj, Aliaj, Gradec, Hot, Jeran, Pjetroshan, Rrapshë, Vukpalaj, Premal, Goraj-Budishtë, Kastrat, and Bratosh.
Kelmend	6135	Fshtrat: Tamarë, Brojë, Kozhnje, Selcë, Vukël, Lëpushë, Vermosh, Nikç.

Grupi i punës:

- E. Laçaj/ Kryetar / Përgjegjës - Sektori i Taksave dhe Tariafve Vendore
- R. Taflaj/ Anëtar/ Inspektor - Sektori i Taksave dhe Tariafve Vendore
- D. Hoxhaj/ Anëtar/ Inspektor - Sektori i Taksave dhe Tariafve Vendore
- A. Gjoka/ Anëtar/ Juriste - Sektori Juridik
- F. Ujkaj/ Anëtar/ Përgjegjës - Sektori i Zhvillimit Urban

Kuadri ligjor dhe nënligjor.

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Më poshtë si vijon janë paraqitur ndryshimet e këtij ligji si dhe gjithë kuadri tjetër ligjor dhe nënligjor në të cilën jemi bazuar për të paraqitur taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021.

Për procesin e hartimit të paketës fiskale janë zhvilluar seanca konsultimi bazuar në nenin 18 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Ligje:

- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- Ligji nr. 9632 dt 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” i ndryshuar.
- Ligji nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 142/2015 “ Për disa ndryshime dhe shtesa dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar.
- Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, dt.27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji nr. 9975 “Për Taksat Kombëtare i ndryshuar”.
- Ligji nr. 8438 dt 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 107 /2014”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ”i ndryshuar
- Ligji nr. 9936 i dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne RSH” i ndryshuar.
- Ligji nr 5 /2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.10465 dt 29.09.2011“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr 10/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8308 i dt 18.03.1998 “Për Transportin Rrugor” i ndryshuar .
- Ligji nr. 152/ 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri”
- Ligji nr 9920 dt 19.05.2008 ”Për procedurat Tatimore në R.SH.” të ndryshuar me ligjin nr. 164\2014.
- Ligji nr. 10463 dt 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të Mbetjeve Urbane“, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8308 dt 18.03.1998 “Për Transportin Rrugor“,i ndryshuar.
- Ligji nr. 10279 dt 20.05.2010 “Për Kundravajtjet administrative“.
- Ligji nr 10296 dt 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“,i ndryshuar.
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

- Ligj nr.10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave
- Ligji nr.10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr.8378, dt.22.07.1998 „Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar.
- Ligji nr. 24/2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit“, miratuar me dt.09.03.2017.
- Ligji nr.98/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar
- Ligj nr. 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar
- Ligji nr. 92/ 2014 “Për Tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr. 95/ 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar”.

Vendime dhe udhëzime:

- VKM 783 dt 10.11.2011 “Per procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- VKM nr 408 dt 13.05.2015 “Për miratimin e zhvillimit të territorit”, i ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2 i dt 06.02.2012 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar.
- VKM nr 433 dt 08.06.2016,“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit”.
- VKM nr 438 dt 08.06.2016 “Për Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të Pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”.
- Udhëzimi nr.01 i datë 09.06.2016 “Për rregullat dhe procedurat e kërkimit të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor e publik”.
- Udhëzim nr.2 i dt 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, dhe livadheve të procedurave për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari“
- Udhëzimin nr. 5627 dt. 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në Transportin Rrugor të udhëtarve brenda vendit”,
- VKM 285 dt 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridike fizike e vendas të huaj”.
- VKM 707,datë 12.10.2016 “Për Tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të ofruara nga bashkitë e paisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione shërbimi të MZSH”.
- Vendim nr. 1064 i dt 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

- Udhëzim nr.1 dt 09.06.2016,“Për rregullat procedurat e kërimit të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik“.
- VKM nr.970 dt 02.12.2015 “Për Përcaktimin e Proedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe të nënprodukteve të saj” i ndryshuar.
- VKM nr. 344, datë 19.4.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”
- VKM nr.1096 datë 28.12.2015 “Për Miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”,
- VKM nr.54,datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar .
- Udhëzimi nr. 30,datë 27.12.2011,“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik“ i ndryshuar.
- Shkresës së Ministrit të Financave nr. 17905/1, dt.27.12.2016 “Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesat në tarifën e pagesave për liçenca/certifikata”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.132 datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategoritë specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”.
- Vendimi nr.408 dt.13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“ i ndryshuar,
- VKB nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të Mbetjeve”

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1: TAKSAT VENDORE.....	8
I.1. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme.	8
a. Taksa mbi ndërtesën.....	9
b. Taksa mbi tokën bujqësore.....	12
c. Taksa mbi truallin (Jo hapësirë Publike).	13
I.2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.....	14
I.3. Taksa e fjetjes në hotel	16
I.4. Taksa e tabelës	17
I.5. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.....	19
I.6. Të ardhura nga taksat e ndara (taksa kombëtare).	20
a. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	21
b. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.....	22
c. Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare	22
ç. Taksa vendore mbi të ardhurat personale.	23
II.1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe Tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit	24
II.1.1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	24
II.1.2. Tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit	27
II.2. Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Malësi e Madhe	29
II.3. Tarifa e parkimit të automjeteve.	29
II.4. Të ardhura nga Shërbimi Pyjor.	31
II.5. Tarifa të Drejtorisë së Projekteve dhe Planifikimit Urban.....	31
II.6. Tarifa nga Agjensia e P.M.N.Z.SH. Malësi e Madhe	32
II.7. Tarifa të Sektorit të Shërbimeve Veterinar.	33
II.8. Tarifë për linjat nëntokësore.	33
II.9. Tarifa e zënies së hapësirës publike.	34
II.10. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës ujitje- kullim dhe tarifa e shërbimit të ujitjes.	36
II.11. Tarifa e shërbimit në Fushën e Transportit.....	36
II.12. Tarifa për dhënie liçence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.	37
II.13. Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi ose në përdorim.	38
Kapitulli III: GJOBAT.....	39
III.1. Gjobat për shkeljet dhe kundravajtjet administrative.....	39
III. 2. Gjobat për mos shlyrjen në afat të detyrimit.	41
Kapitulli IV: LEHTËSIRA FISKALE.....	42
Kapitulli V: ANKIMI.....	43

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave për qëllime banimi referuar aneksit 1 dhe 2 të VKM nr. 132, datë 07.03.2018 që do të përdoren për llogaritjen e vlerës së pasurisë, sipas njësive.	10
Tabela 2: Vlera e taksës për m ² ndërtesë që përdoret për qëllime banimi e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 132 datë 7.03.2018, referuar anekseve 1 dhe 2 të këtij VKM.....	10
Tabela 3: Vlera e taksës për m ² ndërtesë që përdoret për veprimtari ekonomike e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 132 datë 07.03.2018, referuar anekseve 1 dhe 2 të këtij VKM.	10
Tabela 4: Niveli i taksës për pasurinë e paluajtshme - tokë bujqësore sipas kategorive	12
Tabela 5: Niveli i taksës mbi truallin.....	13
Tabela 6: Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	14
Tabela 7: Niveli taksës së fjetjes në hotel.	16
Tabela 8: Niveli i Taksës së tabelës sipas kategorive.....	17
Tabela 9: Niveli i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë	21
Tabela 10: Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë “Familje”.....	24
Tabela 11: Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë “Biznes dhe institucione”	25
Tabela 12: Nivelet e tarifës së ndriçimit dhe gjelbërimit për kategorinë “Familje”	28
Tabela 13: Nivelet e tarifës së ndriçimit dhe gjelbërimit për kategorinë “Biznes dhe Institucione”	28
Tabela 14: Niveli i tarifës së shërbimeve administrative.....	29
Tabela 15: Niveli i tarifës së parkimit të automjeteve.	30
Tabela 16: Nivelet e tarifave të Sektorit të Zhvillimit Urban	31
Tabela 17: Nivelet e tarifës për leje dhe shërbim veteriner	33
Tabela 18: Nivelet e tarifës për linjat nëntokësore.....	34
Tabela 19: Nivelet e tarifës për zënien hapësirës publike për qëllime biznesi	34
Tabela 20: Niveli i tarifës vjetore të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe shërbimit të ujitjes	36
Tabela 21: Nivelet e tarifës për shërbimin në fushën e transportit	37
Tabela 22: Nivelet e tarifës për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. ..	38
Tabela 23: Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative	39
Tabela 24: Niveli i gjobave për mosshlyrje në afat të detyrimit:	41

KAPITULLI 1: TAKSAT VENDORE

Ky kapitull trajton taksat vendore duke u nisur nga elementët: - Lloji, niveli i takses, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kushtet lehtësuese, përjashtimet nga pagesa e taksës, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve.

I.1. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme.

Baza Ligjore: Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar; neni 2 dhe 4, Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/a, neni 12 pika 5, Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 9, 20, 21, 22.

Përkufizimi: “Pasuri e paluajtshme” janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Përjashtohen rastet e përcaktuara ndryshe në ligj. Pronari ose bashkëpronarët janë të detyruar të paguajnë taksën mbi pasurinë e paluajtshme, në bazë të përqindjes së pronës në posedim.

“Kadastra Fiskale” është regjistri qëndror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i pasurisë së paluajtshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së pasurisë, pranë bashkisë ku ndodhet pasuria. Këshilli i Bashkisë në rastet të mungesës së dokumentacionit ligjor ngre Komisionin e Verifikimit të Pasurive të Paluajtshme, ku nëpërmjet tij vlerëson sipërfaqen që do jetë e taksueshme. Për taksën e pasurisë së paluajtshme, Këshilli Bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 % dhe minus 30 % të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, për efektet të pagimit të detyrimit tatimor, kur prona nuk është e regjistruar në ZRPP, njeh si dokumentacion:

- a) Vendimet e komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronës
- b) Vendimet e privatizimit
- c) Dokumenta të tjera të lëshuara nga organet përkatëse në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në taksën mbi pasuritë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

a. Taksa mbi ndërtesën.

Baza ligjore: Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, nenet 22, 22/1, 22/2, 22/3, 22/4, dhe neni 22/5, Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.132 datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategoritë specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, neni 2 pika 1, 1.1, 1.2, 1.3, 2, 2.1, 3, Aneksi 1 dhe Aneksi 2. Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2.

Baza e taksueshme: Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave (vlerës së tregut).

Shkalla e taksës: Shkalla e taksës mbi ndërtesat aplikohet si përqindje e bazës së taksës dhe është si më poshtë:

- 0.05 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim.
- 0.2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
- 30 % e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”

Përcaktimi i bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjek këtë radhë vlerësimi:

1. Vetëdeklarimi (*Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.*)
2. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ZVRPP).
3. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/ njësive pronësore (*Kur vlerësimi sipas pikave 1dhe 2 më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve*)
4. Gajtë verifikimit në terren nëse nuk sigurohet informacion lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/ njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren, si më poshtë:
 - Sipërfaqja e prezumuar nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/ njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqen e verifikuar në terren, si më poshtë:
 - 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim.
 - 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.

Këshilli Bashkiak redukton çmimin mesatar referues të përcaktuar në Aneksin 1 të VKM nr.132 datë 07.03.2018, në masën 35% për banesat për qëllime banimi në Njësitë Administrative jashtë qytetit të Koplikut.

Tabela 1: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave **për qëllime banimi** referuar aneksit 1 dhe 2 të VKM nr. 132, datë 07.03.2018 që do të përdoren për llogaritjen e vlerës së pasurisë, sipas njësive.

Nr.	Bashkia Malësi e Madhe	Çmimi referues lekë/ m ²
1	Njësia Administrative Koplik	40500
2	Njësia Administrative Qendër	26325
3	Njësia Administrative Kastrat	26325
4	Njësia Administrative Gruemirë	26325
5	Njësia Administrative Shkrel	26325
6	Njësia Administrative Kelmend	26325

Tabela 2: Vlera e taksës për m² ndërtesë që përdoret **për qëllime banimi** e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 132 datë 7.03.2018, referuar anekseve 1 dhe 2 të këtij VKM.

- Shkalla e taksës është 0.05%.

Bashkia Malësi e Madhe	Çmimi referues lekë/ m ²	Vlera e taksës për metër katror për banesat që përdoren/shrytëzohen për banim në lekë			
		Shtëpi/ Apartament	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i Hapur (0.3)	Banesa të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)
Njësia Administrative Koplik	40500	20.25	14.18	6.08	14.18
Njësia Administrative Qendër	26325	13.16	9.21	3.95	9.21
Njësia Administrative Kastrat	26325	13.16	9.21	3.95	9.21
Njësia Administrative Gruemirë	26325	13.16	9.21	3.95	9.21
Njësia Administrative Shkrel	26325	13.16	9.21	3.95	9.21
Njësia Administrative Kelmend	26325	13.16	9.21	3.95	9.21

Tabela 3: Vlera e taksës për m² ndërtesë që përdoret për **veprimtari ekonomike** e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 132 datë 07.03.2018, referuar anekseve 1 dhe 2 të këtij VKM.

- Shkalla e taksës është 0.2%.

Njësia Administrative	Çmimi referues lekë/ m ²	Vlera e taksës për metër katror për banesat që përdoren/shrytëzohen për veprimtari ekonomike në lekë				
		Njësi tregtimi dhe shërbimi (150%)	Për parkime të mbuluara dhe bodrume (70%)	Për parkime të hapura (30%)	Për veprimtari industriale (50%)	Për veprimtari bujqësore dhe blegtorale (30%)
Koplik	40500	121.5	56.70	24.30	40.50	24.30
Qendër	26325	78.98	36.86	15.80	26.33	15.80
Kastrat	26325	78.98	36.86	15.80	26.33	15.80
Gruemirë	26325	78.98	36.86	15.80	26.33	15.80
Shkrel	26325	78.98	36.86	15.80	26.33	15.80
Kelmend	26325	78.98	36.86	15.80	26.33	15.80

Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652/ 1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” të ndryshuar, çmimi për metër katror (m²) është 70% (shtatëdhjetë për qind) e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

Detyrimi për pagesë të taksës: Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen ndividët, personat fizik ose juridik, vendës ose të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përvec rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen persona që kanë aplikuar për legalizimin e ndërtesës sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si dhe zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit (në këtë rast afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi).

Detyrimi për taksën vendore mbi pasurinë e paluajtshme - ndërtesë është vjetor. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave. Detyrimi i pagesës llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 30 qershor të vitit aktual.

Përfshirje nga pagimi i taksës:

- a) Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara.
- ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive.
- d) Pasuritë e paluajtshme- ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale.
- dh) Ndërtesat që përdoren nga komunitet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre.
- e) Struktura akumuluese “Hotel/ Resort me katër yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.
- ë) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/ pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë.
- f) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- g) Ndërtesat kulturore nën mbrotje të përkohshme, për kohën në të cilën deklarohet mbrotja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat bashkë me nënkategorizimet është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

b. Taksa mbi tokën bujqësore

Baza ligjore: Ligji nr.9632,datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 “Taksa mbi token bujqësore”, i ndryshuar me Ligjin nr.142 datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632/2006”, Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/a. Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 6, ANEKSI 1.

Përkufizimi: “*Tokë bujqësore*” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurive.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. (*Dokumentet e pronësisë, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës*). Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore janë të ardhura që derdhen 100% për llogari të buxhetit të Bashkisë.

Niveli i taksës së tokës bujqësore: Niveli i taksës mbi pasuritë e paluajtshme- tokë bujqësore caktohet në lekë për hektar. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Tabela 4: Niveli i taksës për pasurinë e paluajtshme - tokë bujqësore sipas kategorive

Kategoria e tokës.	Njësia	Niveli i taksës
I	Lekë/ ha/ vit	1400
II	Lekë/ ha/ vit	1200
III	Lekë/ ha/ vit	1100
IV	Lekë/ ha/ vit	1000
V	Lekë/ ha/ vit	900
VI	Lekë/ ha/ vit	800
VII-X	Lekë/ ha/ vit	700

Shënim:

- Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.*
- Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka bujqësore.*
- Gjithashtu Sektori i Kadastres Urbane dhe Zhvillimit Rural, ngarkohet për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herepashershme, dhe ja percjelle kete informacion me shkrim, Sektorit të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për llogaritjen e detyrimit.*

Detyrimi për pagesë të taksës: Detyrimi për pagesën e taksës mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga si shumëzim i nivelit të taksës me sipërfaqen e tokës bujqësore.

Përjashtime: Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi token bujqësore është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative, si dhe sipas informacioniot të sjellë nga Sektori i Kadastres Urbane dhe Zhvillimit Rural.

c. Taksa mbi truallin (Jo hapësirë Publike).

Baza ligjore: Ligji 142/2015, date 21.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9632, 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 23/1,; Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/a; Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 7, ANEKSI 2.

Përkufizim: Truall është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës mbi truallin: Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Për çdo kategori minimale të truallit, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Tabela 5. Niveli i taksës mbi truallin

Lloji taksës	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qëllime biznesi
A. Taksë trualli	0,14 lekë/m ²	12 lekë/m ²

Detyrimi për pagesë të taksës: Detyrimi për pagesën e taksës mbi truallin është vjetor. Detyrimi i taksës llogaritet në bazë të sipërfaqës dhe vlerës së taksës.

Detyrimi për taksën e truallit për bizneset do të llogaritet në bazë të sipërfaqës së ndërtesës së aktivitetit, deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqës së truallit.

Detyrimi taksës së truallit për biznesin shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 30 qershor të vitit aktual.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

I.2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza ligjore: Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 27, i ndryshuar me Ligjin Nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar neni 14, ligjin 41/2018 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe me ligjin 98/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar neni 27, pika 3, shkronja c dhe pika 9, Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 46; Ligji nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/b; Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, neni 7; Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27 pika 1 dhe 2 në përputhje me ligjin 9632/2016 i ndryshuar. Ligji nr.95/ 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632 dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 9. ligj nr.10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave, neni12.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m² të investimit të ri sipas preventivit. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Tabela 6. Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Nr	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Njësia	Sipas ligjit	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë	
				Banimi	Biznesi
1-	Ndërtime e destinuara për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi të cilat kryhen nga shoqëritë e ndërtimit. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.	Në % të cmimit të shitjes për m ²	4-8%	4%	6%
2-	Ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër, për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individit apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	Në % të vlerës së investimit	1-3%	2%	3%

3-	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	Në % të vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimeve	0,1 %	0,1 %	0,1 %
4-	Për ndërtesat , të cilat janë në proces legalizimi.	Në % të vlerës së investimit.	0.5 %	0.5 %	0.5 %
5-	Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore.	Në % të vlerës së investimit	0-3%	2%	-

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturen e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat e dyta: Në rast se një subjekti posedon më shumë se një ndërtim pa leje, atëherë ai ka të drejtë të zgjedhë se për cilin objekt do të përfitojë kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore dhe legalizimin sipas çmimit, taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës së shërbimit të legalizimit. Për ndërtesat e tjera, më shumë se një ndërtim pa leje, në proces legalizimi do të taksohet sipas nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë të paraqitur në tabelën mësipër (Tabela 6).

Për ndërtimet e tjera zbatohet çmimi i përcaktuar në bazë të hartës së vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, taksa e ndikimit në infrastrukturë, sipas masës në fuqi dhe tarifa e shërbimit, pavarësisht nga kategorizimi i funksionit të objekteve apo sipërfaqja e parcelës ndërtimore.

Detyrimi për pagesën e taksës: Detyrimi për taksën i takon investitorit. Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive. E ardhura nga taksa për çdo rast mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të Bashkisë që mbulon territorin ku do të bëhet investimi. Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Përjashtime nga pagimi i taksës:

-Përjashtohet nga pagesa e kësaj takse, investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/ Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

-Përfashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit. Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

- Përfashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për mbrotjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfashtim nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

-Përfashtohen Objektet e Kultit të bashkësive fetare, sipas nenit 12, ligjit Nr. 10140, datë 15.5.2009. *“Për legalizimin e objekteve të kultit, të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, objekteve me destinacion për shërbime sociale a shëndetësore, bashkësitë fetare përfashtohen nga pagesat, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.*

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Sektori i Zhvillimit Urban, i cili përcjell informacionin tek Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore që bën vjeljen e taksës. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit për objektet e reja pranë Bashkisë Malësi e Madhe, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë pranë Sektorit të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifavat Vendore të Bashkisë Malësi e Madhe.

I.3. Taksa e fjetjes në hotel

Baza ligjore: Ligji nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 26, ANEKSI 8.

Përkufizimi: Me “Hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe këto struktura akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: Hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës: Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Tabela 7: Niveli taksës së fjetjes në hotel.

Emërtimi	Nivelet e taksës
A. Hotelet 4-5 yje	105 lekë/ person/ netë fjetje
B. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë/ person/ netë fjetje

Për Sektorin e Taksave njihet si tatimpagues pronari i hotelit ose sipas rastit personi që ka të regjistruar aktivitetin dhe likuidimi i kësaj takse bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Detyrimi për pagesën e taksës së fjetjes në hotel dhe kështu e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e

netëve të qëndrimit në hotel. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Sektori i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

I.4. Taksa e tabelës

Baza ligjore: Ligji nr. 106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, neni 8, Aneksi 7 “Taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive” Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 10.

Baza e taksës: Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Tabela 8: Niveli i Taksës së tabelës sipas kategorive.

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Njësia Matëse	Vlera
I.	Taksë table për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ ose aktiviteti i biznesit)		
a	<i>Deri në 2 m²</i>	Lekë/ m ² / vit	0
b	<i>-mbi 2 m² deri 10 m²</i>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/ m ² / vit	7 000
	-Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/ m ² / vit	11 500
	-elektronike	Lekë/ m ² / vit	15 000
c	<i>Mbi 10 m² deri 20 m²</i>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/ m ² / vit	5 950
	-Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/ m ² / vit	9 775
	-elektronike	Lekë/ m ² / vit	12 750
ç	<i>Mbi 20 m² deri 40 m²</i>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/ m ² / vit	3 850
	-Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/ m ² / vit	6 325
	-elektronike	Lekë/ m ² / vit	8 250
d	<i>Mbi 40 m²</i>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/ m ² / vit	2 800

	-Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/ m ² / vit	4 600
	-elektronike	Lekë/ m ² / vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	-Tabelë identifikuese	Lekë/ m ² / vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme/ e palëvizshme		
	e thjeshtë (me/ pa ndriçim)	Lekë/ m ² / vit	13 500
	-elektronike	Lekë/ m ² / vit	27 000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	- të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/ m ² / ditë	1 000

Kategorizimet e tabelave:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Përfundime: Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përfundim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Përfundohen nga pagesa e taksës së tabelës subjektet me statusin e Ambulantit.

Mënyra e vlerësimit: Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e

pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

- Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

- Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.

Struktura e ngarkuar për dhënie leje: Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është Sektori i Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Malësi e Madhe bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.

Struktura e ngarkuar për identifikim, matjen dhe përlllogaritjen: Struktura e ngarkuar për identifikim, matjen dhe përlllogaritjen e kësaj takse është Sektori i Zhvillimit Urban dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse: Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

Struktura e ngarkuar për penalitetet: Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendosje tabele reklamuese është Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Sektori i Zhvillimit Urban harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 30 qershor të vitit aktual.

I.5. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza Ligjore: Ligji 142/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 5 dhe 6, Ligji nr.9632, 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 10, 11,15, 17 dhe 18, ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 11; Ligji nr.92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin 142/2015. Udhëzim i Ministrit të Financave Nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi

fitimin e biznesit të vogël”, i ndryshuar. Ligj nr. 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 1,2

Përkufizim: Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme.

Baza e tatimit: Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Forma dhe përmbajtja e deklaratave tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Shkalla tatimore: Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).”.

Detyrimi për pagesë të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, 4 këste vjetore të ndarë në tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël deri më

- 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars;
- 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor,
- 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator;
- 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, me datë 10 të muajit pasardhës. Agjenti tatimor merr një komision prej 1% (një përqind) për shërbimin e kryer, vlerë e cila derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

Struktura përgjegjëse për kryerjen e akt-rakordimeve: Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore është përgjegjës për rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Shkodër.

I.6. Të ardhura nga taksat e ndara (taksa kombëtare).

Baza ligjore: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 32 i ndryshuar; Ligji nr.68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11, pika ë, neni 25.

- a- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
- b- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura
- c- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
- ç- Të ardhura nga taksa vendore mbi të ardhurat personale

a. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza ligjore: Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 28 “Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme” dhe ANEKSI 3 (ndryshuar me ligjin nr. 142/ 2015).

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme (tokë bujqësore truall) është vlera e shitjes së tyre.

Niveli i taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme (tokë bujqësore truall) caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës **është 2 për qind**. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë caktohet në lek për m² të bazës së taksës.

Tabela 9: Niveli i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë

Shkalla tatimore	Njësia	Shkalla Tatimore
A. Ndërtesa banimi	lekë/ m ²	100
B. Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime	lekë/ m ²	300
C. Ndërtesa të tjera	lekë/ m ²	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Përfshirje nga pagimi i taksës: Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a. Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet përkatëse;
- c. Subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore.
 - Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor, të cilat përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë (97%), në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

b. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Baza ligjore: VKM nr.783, datë 10.11.2011 “Për Procedurat e ndarjes së të ardhurave të Taksës Vjetore të mjeteve të përdorura në njësitë e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/ 2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 25 pika 2/b; VKM Nr. 923, datë 29.12.2014 “Për një ndryshim në vendimin nr. 783, datë 10.11.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e ndarjes të të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 14, datë 30.4.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për Taksat kombëtare””, i ndryshuar.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

Baza e taksueshme: Baza e taksës së mjeteve të përdorura është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Niveli i taksës: Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për pagimin e taksës së mjeteve të përdorura i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. 25 % e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore.

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

c. Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza ligjore: Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”; neni 40. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 25 pika 2/c.

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin e tij.

Detyrimi për pagesën e taksës: Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ ose vepron në

industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, **5%** e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Malësi e Madhe, në llogarinë e degës së thesarit.

Ngarkohet Sektori i Finances dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për kryerjen e rakordimeve me agjentët e kësaj takse, dhe arkëtimin e saj në llogari të Bashkisë Malësi e Madhe.

ç. Taksa vendore mbi të ardhurat personale.

Baza ligjore: Ligji nr.68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/e, 25 pika 2/ç.

Taksa vendore mbi të ardhurat personale hyn në kategorinë e “taksave të ndara”. Është taksë kombëtare që një përqindje të saj e marrin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të ardhurat që realizohen në juridiksionin e tyre. Bashkisë Malësi e Madhe i kalon një përqindje prej **2%** e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Udhëzimi mbi për procedurat e ndjekjes deri në kalimin e kësaj të ardhura në llogari të Njësive Vendore bëhet sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave.

KAPITULLI II: TARIFAT VENDORE.

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët: - Llojit të shërbimit, nivelit të tarifës bazuar në koston e shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

II.1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe Tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit

II.1.1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Baza ligjore: Ligji 139/ 2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3 b. Ligji nr.68/ 2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 14 pika 2 dhe 5/b. VKB nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të Mbetjeve”

Niveli i Tarifës së pastrimit është llogaritur duke bërë ndarje në përqindje të përfituesëve të shërbimit të pastrimit në tre kategor: “Familje”, “Biznes” dhe Institucione shtetërore ku kategoria “Familje” zë 40% të totalit të koston të ofrimit të shërbimit, kategoria “Biznes” zë 50% dhe kategoria institucione zë një peshë prej 10% të totalit të koston.

Përkufizime: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, që jetojnë apo ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Malësi e Madhe dhe njësive të saj administrative.

Në rastin kur subjekti krijohet (regjistrohet) apo mbyllet gjatë vitit kalendarik, detyrimi për tarifën e pastrimit llogaritet dhe arkëtohet proporcionalisht me kohën aktive të ushtrimit të aktivitetit.

Afati i pagesës së këtyre detyrimeve është data 30 qershor e vitit aktual kalendarik.

Baza e tarifës: është vlera në lekë e llogaritur sipas koston të shërbimit të ofruar në të gjithë territorin që është nën juridiksionin e Bashkisë Malësi e Madhe.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për tarifën është vjetor.

Tabela 10: Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë “Familje”

	Familje me 1 anëtarë	Familje me 2 ose më shumë anëtarë
	Lekë/ vit/ familje	Lekë/ vit/ familje
Koplik	1300	2500
Qendër	800	1500
Kastrat	900	1700
Gruemirë	900	1700
Shkrel	900	1700
Kelmend	800	1500

Shënim: Perjashtohen nga detyrimi i tarifës së pastrimit të gjithë taksapaguesit nga fshatrat që nuk ju ofrohet shërbimi (deri në momentin që ky shërbim të iu ofrohet), si: Vukël, Nikç, Kozhnje, Brojë, Vorfë, Kurtaj, Vajush, Linaj- Lepurosh- Egç, Mshqerrë Goraj- Budishë, Kastrat, Rrepisht, Kokpapaj.

Tabela 11: Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë “Biznes dhe institucione”

Nr.	Kategorite	Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave		
		Biznes i Vogel	BV- me TVSH	Biznes i madh
I	NJESI TREGTIMI			
1	Tregtim mishi, peshku etj. të ngjashme me to.	7000	10000	45000
2	Tregtim materiale hidrosanitare, elektroshtepiake etj	5000	8000	45000
3	Tregtim bulmet, fruta, perime, artikuj ushqimore, industrial etj. dhe të ngjashme me to.	6000	10000	45000
4	Njësi shitje te ndryshme.	6000	8000	25000
5	Bar kafe, fast-food, etj. të ngjashme me to.	6000	8000	25000
6	Bar-Restorante, restorante	18000	27000	35000
7	Restorant per dasma dhe evente (sezonale)	25000	48000	57000
8	Kafe internet, qendra interneti, etj të ngjashme me to	5000	8000	20000
9	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure, karburante etj.	5000	12000	30000
10	Shitje produkte farmaceutike, farmaci bujqësore, etj	6000	8000	25000
11	Markete	18000	27000	35000
12	Supermarkete	28000	32000	45000
13	Magazina	8000	15000	45000
II	NJESI SHERBIMI	Biznes i Vogel	BV- me TVSH	Biznes i madh
1	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, celulare, etj. të ngjashme me to.	6000	12000	20000
2	Shërbime servisi, agjensi këmbimi valute, agjensi turizmi, agjensi doganore, sigurimesh, funerale, kancelari etj. të ngjashme me to, shërbime (zyra) kredidhënie, etj.	8000	12000	25000
3	Hotele, motele, fjetina, bujtina, kampingje etj.	18000	32000	45000
4	Sallon bukurie, marangoz, rrobaqepës, fotograf, këpucar, dhe të ngjashme me to, etj.	6000	12000	20000
5	Komplekse sportive, palestra, salla fitnesi, sallat e lojrave, pishina, parking,	6000	8000	20000
6	Agroturizëm	18000	32000	45000
7	Njësi shërbimi internet, tv kabllor, etj. të ngjashme me to.	8000	27000	45000
8	Bankat e Nivelit të dytë.	75000	75000	75000
9	Shoqata, Fondazione, Organizata, Subjekte Politike.	10000	15000	45000
10	Ente të ndryshme shtetërore	45000	45000	45000

III	NJËSI PRODHIMI, PËRPUNIMI ETJ.	Biznes i Vogel	BV- me TVSH	Biznes i madh
1	Përpunim bime medicinale, duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi dhe të ngjashme me to.	13000	32000	75000
2	Mbarështim kafshësh, shpendësh dhe të ngjashme me to.	28000	72000	75000
3	Prodhim tulla, përpunim guri, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, etj. të ngjashme me to.	10000	17000	45000
4	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj. të ngjashme me to.	8000	12000	25000
5	Territore për therjen e kafshëve etj. të ngjashme me to.	18000	32000	45000
6	Fasoneri, prodhim veshje dhe të ngjashme me to.	32000	47000	65000
7	Karriera dhe inerte	18000	90000	95000
8	Pike Karburanti	32000	32000	40000
9	Prodhim energjie elektrike dhe te ngjashme me to.	28000	72000	75000
IV	PROFESIONE TE LIRA	Biznes i Vogel	BV- me TVSH	Biznes i madh
1	Avokat, noter, mjek, mjek- laborant, stomatolog, veterinar, ekonomist kontabël, studio arkitekture, inxhinierie etj, të ngjashme me to.	8000	12000	25000
2	Institucionet jopublike të edukimit (çerdhe, kopshte, shkolla, autoshkollë, etj.)	8000	12000	30000
3	Sherbime Online, Telemarketing dhe te ngjashme me to.	5000	7000	15000
V	AMBULANT			
1	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike, shoqerues turistik dhe te ngjashme me to.	5000	5000	5000
VI	TRANSPORT	Biznes i Vogel	BV- me TVSH	Biznes i madh
1	Transport udhëtarësh (lekë/ vit)	2000	5000	10000
2	Transport i mallrave	2000	5000	15000
VII	INSTITUCIONE	Tarifa për instituciont		
1	Deri në 20 punonjës	25000 lekë/ vit		
2	Mbi 20 punonjës -100 punonjës	45000 lekë/ vit		
3	Mbi 100 punonjës- 300 punonjës	50000 lekë/ vit		
4	Mbi 300 punonjës- 500 punonjës	100000 lekë/ vit		
5	Mbi 500 punonjës	150000 lekë/ vit		
6	Institucione te vuajtjes së dënimit	300000 lekë/ vit		

VIII SUBJEKTE NDERTIMI	Tarifa për subjekte ndërtimi
1. <u>Për subjekte ndërtimi me seli administrative</u>	50000 Lekë/ vit
2. <u>Subjekte ndërtimi sipas vlerës investimit dhe kohezgjatjes së kantier ndërtimit</u>	
a Për vlera investimi deri në 5 000 000 lekë	25000 Lekë/ Kantier/ vit
b Për vlera investimi 5 000 001 – 10 000 000 lekë	40000 Lekë/ Kantier/ vit
c Për vlera investimi 10 000 001- 20 000 000 lekë	60000 Lekë/ Kantier/ vit
d Për vlera investimi 20 000 001 – 30 000 000 lekë	70000 Lekë/ Kantier/ vit
e Për vlera investimi 30 000 001 – 40 000 000 lekë	80000 Lekë/ Kantier/ vit
f Për vlera investimi 40 000 001 - 50 000 000 lekë	100000 Lekë/ Kantier/ vit
g Për vlera investimi 50 000 001 - 100 000 000 lekë	150000 Lekë/ Kantier/ vit
h Për vlera investimi 100 000 001- 200 000 000 lekë	200000 Lekë/ Kantier/ vit
i Për vlera investimi mbi 200 000 000 lekë	500000 Lekë/ Kantier/ vit

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategoritë Familje, Biznes dhe Institucione është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkës Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave të Njësive Administrative.

II.1.2. Tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit

Tarifa për ndriçimin dhe gjelberimin është detyrim i çdo taksapaguesi i cili përfiton shërbime të tilla si ndriçim dhe gjelbërim.

Në rastin kur subjekti krijohet (regjistrohet) apo mbyllet gjatë vitit kalendarik, detyrimi për tarifën e ndriçimit dhe gjelbërimit llogaritet dhe arkëtohet proporcionalisht me kohën aktive të ushtrimit të aktivitetit.

Afati i pagesës së këtyre detyrimeve është data 30 qershor e vitit aktual kalendarik.

Baza e tarifës: është vlera në lekë e llogaritur sipas kostos së shërbimit të ofruar në territorin ku ofrohen këto shërbime dhe që është nën juridiksionin e Bashkisë Malësi e Madhe.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për tarifën është vjetor.

Nivelet e tarifave së ndriçimit dhe gjelbërimit për kategoritë dhe nënkategoritë familje, person juridik apo fizik si dhe ne institucione janë të paraqitura në tabelat si më poshtë:

Tabela 12: Nivelet e tarifës së ndriçimit dhe gjelbërimit për kategorinë “*Familje*”

	Tarifë Gjelbërimi	Tarifë Ndriçimi
	Lekë/ vit/ familje	Lekë/ vit/ faamilje
FAMILJARE	100	200

Tabela 13: Nivelet e tarifës së ndriçimit dhe gjelbërimit për kategorinë “*Biznes dhe Institucione*”

BIZNESI	Biznes i vogel		Biznes i vogel me tvsh		Biznes i madh	
Tarifa/ kategori	Gjelbërim lekë/ vit	Ndriçim lekë/ vit	Gjelbërim lekë/ vit	Ndriçim lekë/ vit	Gjelbërim lekë/ vit	Ndriçim lekë/ vit
I. Subjekte Tregtimi	1000	1000	1000	2000	2000	3000
II. subjekte shërbimi	1000	1000	1000	2000	2000	3000
III.Subjekte Prodhimi	1000	1000	1000	2000	2000	3000
IV. profeasione te lira	1000	1000	1000	2000	2000	3000
V.Ambulante	1000	1000	1000	2000	2000	3000
VI. Transport	1000	1000	1000	2000	2000	3000
INSTITUCIONE						
Tarifa/ kategori	Gjelbërim			Ndricim		
Deri në 20 punonjës	1000 lekë/ vit			2000 lekë/ vit		
Mbi 20 punonjës -100 punonjës	1000 lekë/ vit			2000 lekë/ vit		
Mbi 100 punonjës- 300 punonjës	2000 lekë/ vit			3000 lekë/ vit		
Mbi 300 punonjës- 500 punonjës	2000 lekë/ vit			3000 lekë/ vit		
Mbi 500 punonjës	2000 lekë/ vit			3000 lekë/ vit		
SUBJEKTE NDËRTIMI						
Tarifa/ kategori	Gjelbërim			Ndricim		
Me seli administrative	10000 lekë/ vit			20000 lekë/ vit		
Subjekte ndertimi sipas vleres investimit dhe kohezgjatjes se kantier ndertimit	10000 lekë/ kantier/ vit			20000 lekë/ kantier/ vit		

Shënime: Detyrimi për likujdimin e Tarifës ndriçimit dhe tarifës e gjelbërimit lind për Njësine Adminsitrative Koplik, Qytetin Bajzë dhe fshatrat: Hot, Tamarë (qendër), Vermosh (qendër), Razëm (qendër), Dedaj (qendër), Gruemirë (qendër), Koplik i sipërm (qendër) të cilët përfitojnë nga ky shërbim.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës e ndriçimit dhe gjelbërimit për kategoritë Familje, Biznes dhe Institucione është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave të Njësive Administrative.

II.2. Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Malësi e Madhe

Baza ligjore: Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 14 pika 5/d, neni 16.

Përkufimi: Tarifa për shërbimet administrative është detyrim i cili duhet likujduar përpara marrjes së një shërbimi të caktuar (vërtetime, fotokopje dokumentash, njehsime me origjinalin, etj.) nga administrata.

Arkëtimi i këtij detyrimi bëhet pranë Arkës në Bashkinë Malësi e Madhe pas lëshimit të faturës për arkëtim për individin apo personin fizik/juridik nga zyra e taksave dhe tarifave vendore.

Para marrjes së shërbimeve administrative, individët, personat fizike dhe juridike duhet të vërtetojnë që nuk janë debitorë ndaj Bashkisë Malësi e Madhe.

Tabela 14: Niveli i tarifës së shërbimeve administrative

Tarifë për shërbime administrative në Bashkinë Malësi e Madhe	Njësia	Niveli i tarifës
		Për çdo rast shërbimi
1- Për shërbim arkivor, tërheqje dokumentash, njehsime me origjinalin, vërtetime për subjektet etj.	Lekë/vërtetim	500
1.1- Për shërbim arkivor, tërheqje dokumentash, njehsime me origjinalin, vërtetime për subjektet etj. mbi 10 faqe.	Lekë/faqe	10
2- Vërtetime të tjera si: ndihmë ekonomike, saktësim adrese, vjetërsi pune, page etj. të ngjashme me to.	Lekë/vërtetim	100

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative është Sektori të ardhurave nga i Taksat dhe Tarifatat Vendore në bashkëpunim me Arkën pranë Bashkisë Malësi e Madhe dhe Njësive Administrative.

II.3. Tarifa e parkimit të automjeteve.

Baza ligjore: Kodi rrugor ligji 8378 date. 22.07.1998, “Kodi rrugor i RSH” neni 7 germa 1, f; Ligji nr. 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave Vendore” i ndryshuar, neni 35, pika 2; Ligji nr.68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 15 pika 1/c; ligji nr. 107/ 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 13, neni 22 si dhe VKB nr. 21 datë 29.06.2016 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimin e Qendres së Qytetit Koplik”.

Përkufizimi: Tarifa e parkimit të automjeteve është detyrim i çdo individi që përdor apo rezervon vend parkimi (qyteti Bajzë, Koplik).

Detyrimi për pagesën e tarifës: Kjo tarife është vjetore dhe paguhet nga subjektet vetem për një vendodhje të ushtrimit të aktivitetit.

Tabela 15: Niveli i tarifës së parkimit të automjeteve.

	Njësia	Niveli i tarifës
		<i>Sipas çdo rasti</i>
I. Tarifa për subjektet që kërkojnë parkim të rezervuar pranë institucioneve të tyre publike ose private në vende të miratuara nga Këshilli bashkiak:	Lekë/ vit/ mjet	20000
1- Për autoveturat e licensuara taksi (me vende qëndrimi të rezervuara)		
• Autovetura taxi 4+1		18000
• Autovetura taxi 8+1	Lekë/ vit/ mjet	20000
2- Për autobuzat të shoqërive të transportit (pa parkim rezervuar).		
• Autobuza deri në 30 vende	Lekë/ vit/ mjet	10000
• Autobuza mbi 30 vende		8000
3- Automjet transport malli 3.5 – 8 ton	Lekë/ vit/ mjet	5000
4- Automjet transport malli 8 – 14 ton	Lekë/ vit/ mjet	8000
5- Automjet transport malli mbi 14 ton	Lekë/ vit/ mjet	10000
II. Parkim i rezervuar (shesh i miratuar)		
1- Për Autobusa.	Lekë/ vit/ mjet	35000
2 - Taksi 4+1 të licensuara	Lekë/ vit/ mjet	10000
3-Automjet për transport 8+1 të licensuara	Lekë/ vit/ mjet	18000
4-Autovetura	Lekë/ vit/ mjet	23000

Struktura e ngarkuar për miratimin e lejes për vendparkim të rezervuar: Struktura e ngarkuar për miratimin e lejes për vendparkim të rezervuar është Sektori i Zhvillimit Urban, për llogaritjen dhe për vjeljen e tarifës së parkimit është Sektori të ardhurave nga i Taksat dhe Tarifat Vendore.

Struktura e ngarkuar për penalitetet: Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendparkim të rezervuar është Policia Bashkiake.

II.4. Të ardhura nga Shërbimi Pyjor.

Baza ligjore: Ligji 139\ 2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 27 pika 5, pika 6; Ligji nr. 5\2016 “Per shpalljen e moratoriumit në Republikën e Shqipërisë” Neni 6 pika 1; Ligji nr. 48/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, dt. 04.05.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 433, datë 08.06.2016, VKM nr. 438, datë 08.06.2016, Udhëzimi nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat dhe procedurat e kërimit të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullor dhe publik”, VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzimi nr.2, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, dhe livadheve dhe procedurave për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”.

- *Të ardhurat nga shërbimi pyjor do të jenë pjesë e Buxhetit 2021 sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak që do të miratohen në vazhdimësi me propozim të strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat*

II.5. Tarifa të Drejtorisë së Projekteve dhe Planifikimit Urban

Baza ligjore: Ligji 139/ 2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3, germa b; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar neni 10, pika 1, germa b, dhe neni 15, pika 1, germa f , neni 27.

Tabela 16: Nivelet e tarifave të Sektorit të Zhvillimit Urban

Tarifa për kontrollin e zhvillimit të territorit	Njësia	Niveli i tarifës
		Sipas çdo rasti
1- Tarifa për shqyrtim dokumentacioni ose nxerrje dosje		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	5000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	6000
1.1 -Tarife aplikimi për leje zhvillimi,		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	5000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	5000
1.2 -Tarife aplikimi për leje ndërtimi:		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	6000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	6000
2 – Tarifë për aplikim/ shqyrtim dokumentacioni(certifikat përdorimi)		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	3000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	5000
2.1.Tarifë për certifikate përdorimi		
a - për shtëpi banimi	lekë/m ²	30
b - për nevoja biznesi	lekë/m ²	60

3- Tarife për zbardhje dosje:		
3.1-Tarife per zbardhje dosje per objekte banimi	lekë	3500
3.2- Tarife per zbardhje dosje per objekte biznesi	lekë	3500
4- Tarifa për aplikim per shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit		
a - për shtëpi banimi	Lekë/dosje	3000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	4000
5 -Tarife aplikimi per leje per ndryshimin e projektit gjate ndertimit		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	5000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	5000
6 -Tarife aplikimi per Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	5000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	6000
7 - Tarifë për Deklaratë paraprake për kryerje punimesh		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	5000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	5000
8- Tarifë per Leje Infrastruktura	lekë	5000
9- Tarifë për Leje ndërtimi për rikonstrukcion		
a - për shtëpi banimi	Lekë/dosje	5000
b - për nevoja biznesi	Lekë/dosje	6000
10- Leje për prishjen e ndërtimeve	Lekë/dosje	3000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e tarifës së shërbimeve është Sektori i Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Sektori i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore është përgjegjëse për lëshimin e faturës për arkëtim.

II.6. Tarifa nga Agjensia e P.M.N.Z.SH. Malësi e Madhe

Baza ligjore: Të gjitha tarifat që do të aplikohen nga ky sektor do ti referohen bazës ligjore: Ligji 152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri”; VKM nr. 285, datë 27.6.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridik e fizik, vendas dhe të huaj”; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 14 pika 5/ë.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e Akteve dhe të pagesës: Struktura e ngarkuar për lëshimin e Akteve dhe të pagesës për tarifat e shërbimit është Sektori i M. Z.SH. pranë Bashkisë Malësi e Madhe, për lëshimin e afaturavë për arkëtim është përgjegjës Sektori i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore.

II.7. Tarifa të Sektorit të Shërbimeve Veterinar.

Baza ligjore: Ligjit nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” neni 9, pika 1.3, germa b, Ligji Nr.10465, date 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, Akti Normativ Nr.4 datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre” neni 7, pika 2 dhe Vendimin Nr.230 datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, kreu IV, pika 6 dhe 7. Ligji nr. 68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 14 pika 5/ë.

Përkufizimi: Tarifa për shërbimet veterinare përfshin kontrollin nga ana e inspektoriatit veterinar dhe vulosjen e bagëtive.

Detyrimi për pagesë: Tarifa për shërbimet veterinare është detyrim për çdo taksapagues i cili kryen aktivitet të shitjes së mishit të çdo lloji.

Tabela 17: Nivelet e tarifës për leje dhe shërbim veteriner

Nr	Tarifa për therje	Njësia e Matjes	Tarifa e shërbimit
1	Për çdo gjedh të therur	Lekë/ kokë të therur	200
2	Për çdo derr të therur	Lekë/ kokë të therur	200
3	Për çdo bagëti të imët të therur	Lekë/ kokë të therur	100

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimit veteriner janë inspektorët e shërbimit veterinar pranë Bashkisë dhe Njësive Administrative.

II.8. Tarifë për linjat nëntokësore.

Baza ligjore: Ligji.nr.139/2015, dt.17.12.2016 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35, pika 5, gërma ç, ligji 68, datë 27.04.2017, datë 27.04.2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 14 pika 3 dhe pika 5/dh”. Ligji nr. 95/ 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 12.

Baza e tarifës: Baza e tarifës për linjat nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e tarifës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

Tabela 18: Nivelet e tarifës për linjat nëntokësore

Emërtimi i shërbimeve.	Njësia	Niveli i tarifës	
		Nj. A. Koplik	Nj.Ad. të tjera
Linja nëntokësore (“Për rrjetet kablllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si: tubacione, kanale etj., të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.”).	Lekë/km/vit	6000	6000

Shënim: Të ardhurat e siguruara prej tyre shërbejnë për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për linjat nëntokësore është Sektori i të Ardhurave nga Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

Për dhënien e lejes ngarkohet Sektori i Zhvillimit Urban pranë Bashkisë.

II.9. Tarifa e zënies së hapësirës publike.

Baza ligjore: Ligji 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3; Ligji nr. 142/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006”, neni 16, pika c, VKM nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 14 pika 5/a, neni 15.

Baza e tarifës: Baza e tarifës për zënien e hapësirave publike është Sipërfaqja/ m² e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi.

Tarifa për zënien e hapësirës publike llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar. Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

Tabela 19: Nivelet e tarifës për zënien hapësirës publike për qëllime biznesi

Kategoria dhe nënkategoria Sipas llojeve të tregtimit, shërbimeve, etj..		Niveli tregues i tarifës Nj. Administrative Koplik	Niveli tregues tarifës Nj.Administrative. të tjera
1	Zënia e hapësirës publike (për qëllime biznesi, tavolina për bar dhe restorante etj.)	60 lekë/m ²	30 lekë/m ²

2	Spektakle ose panaiere të ndryshme, ngritje tendash dhe mjeteve të tjera për përdorim të përkohshëm, kamping etj.	60 lekë/m ²	30 lekë/m ²
3	Për përdorime të tabelave të reklamës.	60 lekë/m ²	30 lekë/m ²
4	Për zënien e hapësirës publike për rulote dhe trailer.	60 lekë/m ²	30 lekë/m ²
5	Për zënien e hapësirës publike për restorante dhe mjedise të tjera argëtimi pranë lumenjve ose liqen.	60 lekë/m ²	30 lekë/m ²
6	Për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit.	60 lekë/m ²	30 lekë/m ²
Kategoria dhe nënkategoria		Niveli tregues i tarifës/ ditor Nj.Administrative Koplik	Niveli tregues tarifës/ ditor Nj.Administrative. të tjera.
7.	Për tregtim shitje ambulant (ditor)	1000 lekë	500 lekë

Detyrimi i tarifës: përlllogaritët si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelin tregues të saj.

Pagesa e tarifës për zënie të hapësirës publike.

- Për rastin e përdorimit të hapësirës publike me qëllime organizimin e spektakleve ose panaiereve të ndryshme: Detyrimi është në raport me kohën e përdorimit sipas lejes së dhënë.
- Për rastin e përdorimit të truallit (hapësirë publike) për qëllime ushtrim aktiviteti tregtar, si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqe e zënë me platforma, sipërfaqe të rrethuar me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj. të ngjashme me to: Detyrimi është në raport me muajt që do ta përdoret kjo hapësirë sipas kontratës.
- Spektori i Zhvillimit Urban dhe Spektori i Turizmit ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e sipërfaqeve dhe dhënien e lejes, matjen dhe përlllogaritjen.
- Spektori Juridik ngarkohet për përgatitjen e kontratës.
- Spektori i Taksave e Tarifave Vendore pranë Bashkinë Malësi e Madhe është i ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife.
- Pagesa kryhet para lidhjes së kontratës.
- Policia Bashkiake është Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për zënie hapësirë publike.

Përfundim: Përfundohen nga tarifa e e zënies së hapësirës publike aktivitetet e organizuara në partneritet me Bashkinë Malësi e Madhe për promovimin e produktit territorial.

II.10. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës ujitje- kullim dhe tarifa e shërbimit të ujitjes.

Baza ligjore: Ligji nr.24/2017 " Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit", miratuar me dt.09.03.2017, neni 10 pika 2, neni 15, neni 16 pika a dhe b , neni 17, neni 18, neni 19, Ligji 68/2017, dt.27.04.2017 ,datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 14 pika 5/ç.

Tabela 20: Niveli i tarifës vjetore të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe shërbimit të ujitjes

Kategori, nënkategori e tarifës	Lekë	Niveli i tarifës
për ujitjen dhe kullimin		
• Tarifa vjetore e mirëmbajtjes infrastrukturës ujitjes e kullimit.	Lekë/ dynym/ vit	150
• Tarifa e shërbimit të Ujitjes	Lekë/ orë/ ujitje	200

Shënim:

a) Tarifa e mësipërme përfshin vetëm fshatrat e Njesisë Administrative Gruemirë që janë pjesë e sistemit të Ujitjes.

Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 30 Qershor të çdo viti.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj takes është Bordi i Kullimit në bashkëpunim me Sektorin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore.

II.11. Tarifa e shërbimit në Fushën e Transportit

Baza ligjore: Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor”, i ndryshuar, neni 14 dhe 15, neni 35, 36; Ligji nr.10/ 2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor” neni 5, neni 35, 36, 36/1, 37; Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, neni 8 pika 2; Udhëzimi nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”; Udhëzimi nr. 5630, datë 21.11.2016 “Për kriteret e liçesimit për të kryer kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të paisjeve”; Udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 17.02.2011, neni 19, neni 22 dhe neni 23.

Tabela 21: Nivelet e tarifës për shërbimin në fushën e transportit

Kategoritë, nënkategoritë	Njësia	Niveli i tarifës (në lekë)
		Afati 10 vjeçar
I. TRANSPORT UDHËTARËSH BRENDA VENDIT		
1- Liçencë për kryerjen e shërbimeve në linje të rregullt rrethqytetëse	Për linje	40000
-Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për mjet	7500
Kategoritë, nënkategoritë	Njësia	Niveli i tarifës Afati 5 vjeçar
2- Liçencë për kryerjen e shërbimeve në linje të rregullt të specializuara	Për linjë	20000
-Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt të specializuara	Për mjet	7500
3- Liçencë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerres) të udhëtarëve	Për linjë	20000
-Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerres) të udhëtarëve	Për mjet	7500
II. TRANSPORT MALLRASH BRENDA VENDIT		Afati 5 vjeçar
1- Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	Për liçencë	40000
-Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	Ton/ vit	100* ¹
2-Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	Ton/ vit	100*
3- Çertifikatë për tërheqës	Për tërheqës	7500
III. SHËRBIME TRANSPORTI		Afati 5 vjeçar
1- Liçencë për shërbim udhëtarësh me taksi	Për liçencë	20000
2- Licencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Për liçencë	15000
IV. SHËRBIME TË TJERA		
1- Autorizim i përkohshëm një mujor.	Për autorizim	2000
2- Autorizim i përkohshëm ditor.	Për autorizim	500

Shënim:

a) Për duplikate me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.

b) Për rastet e ndryshimeve në liçencë/ çertifikate që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj., paguhet 30% e vlerës së plotë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Ngarkohet Sektori i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe për llogaritjen dhe arkëtimin e këtyre tarifave, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake.

II.12. Tarifa për dhënie liçence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Baza ligjore: Ligji nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, neni 20 pika 2; VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 1, gërma b, pika 3 i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”; Ligji 68/ 2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 14 pika 5/ë.

¹ *Vlefë e dalë nga llogaritja e ton/ kapacitet do të shumëzohet me afatin kohor.

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Malësi e Madhe, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj. Afati i vlefshmërisë së licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është 5 vite nga data e lëshimit.

Tabela 22: Nivelet e tarifës për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Tarifë për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	Njësia	Niveli i Tarifës për afat 5 vjeçar
1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante.	Lekë/ licencë	1 000 000
2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë.	Lekë/ licencë	100 000

Shënim:

a) Në rastin e humbjes osë dëmtimit të këtij dokumenti subjekti ka të drejtë të marrë duplikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie.

b) Për çdo duplikatë paguhet 30% vlerës së plotë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Ngarkohet Sektori i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe për llogaritjen dhe arkëtimin e këtyre tarifave.

II.13. Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi ose në përdorim.

Baza ligjore: VKM Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar,; VKM nr. 992, datë 09.12.2015 “Për përcaktimin kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (Pika 1 dhe 2), ligji nr. 9232, datë 13.05.2015, Ligji nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 19, pika 1.

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhurat nga qiratë paguhet nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Sektori Juridik, Njësia e Prokurimit dhe Sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënies me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore. Ndjekja e zbatimit të kontratës kryhet nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe sektori Juridik (Drejtoria Juridike dhe e menaxhimit të aseteve).

Kapitulli III: GJOBAT

III.1. Gjobat për shkeljet dhe kundravajtjet administrative

Baza ligjore: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6, pika b, neni 7, pika ç, neni 10, pika 3 dhe neni 12; Ligji nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake” i ndryshuar, neni 13; Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 25; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 164/ 2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar neni 22, ligji nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, neni 23, neni 9 pika 1, 3 pika b, neni 54 pika n; Ligji nr.10463/ 2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, VKM nr. 1096/ 2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorim dhe menaxhimin e hapësirës publike” neni 4, 12, dhe 14; Vendimi nr. 408 dt.13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 7 iii; Ligji nr. 10/ 2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin rrugor” i ndryshuar”; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 61, pika 5 dhe 6.

Gjobat do të aplikohen në rastet e kundravajtjeve administrative apo shkeljeve ligjore të ndryshme brenda territorit të administruar nga Bashkia Malësi e Madhe. Përgjegjës për aplikimin dhe vjeljen e këtyre gjobave do të jenë zyrat/ sektore të cilat i kanë nën administrim në bashkëpunim me strukturat e Policisë Bashkiake prane bashkise Malesi e Madhe.

Tabela 23: Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtarë pa licensë, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë :	
1.1. Mospaisje me leje për tregti ambulante, kantinë	2 000 lekë
1.2. Mospaisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit.	20 000 lekë
1.3. Mospaisje me leje për ushtrim aktiviteti “24 orë”	20 000 lekë
1.4. Mospaisje me leje për zënie të hapësirës publike • Veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike.	10 000 lekë
1.5. Mospaisje me deklaratë paraprake punimesh për vendosje reklame : • E thjeshtë • Elektronike	20 000 lekë
1.6. Mospaisje me licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe njërive të shitjes së lëndëve djegëse	20 000 lekë

2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa leje të posaçme të jetë si më poshtë:	
2.1. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete.	20 000 lekë
2.2. Dëmtim të trotuarit apo zënie e tij.	15 000 leke
3. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në rrjetin e ndriçimit rrugor pa leje të posaçme të jetë si më poshtë:	
3.1. Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror, nëntokësor.	10 000 lekë
	20 000 lekë
3.2. Dëmtimi i shtyllave të ndriçimit	15 000 lekë
	20 000 lekë
3.3. Dëmtimi i ndriçuesve	10 000 lekë
	20 000 lekë
3.4. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kablove etj.	10 000 lekë
4. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë:	
4.1. Dëmtimi i hapësirës publike të gjelbërta.	10 000 lekë
	20 000 lekë
4.2. Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve.	10 000 lekë
	20 000 lekë
4.3. Zënie e hapësirë të gjelbër (tavolina, promocione)	20 000 lekë
4.4. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash në pemët dekorative.	10 000 lekë
4.5. Vendosje posterash, njoftimesh në pemët dekorative.	200 lekë/ copë
5. Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë:	
5.1. Për mishin e therur të tregtuar të pa çertifikuar nga Inspektoriati Veterinar.	5 000 deri në 100 000 Lekë
5.2. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të qytetit të Koplikut.	Hera 1: 10 000 Lekë
	Hera 2: 20 000 Lekë
	Për raste të përsëritura deri në konfiskimin të kafshës
5.3. Në rast të konstatimit të tregtimit të kafshëve të prodhimit jashtë tregjeve të miratuara nga Bashkia.	5 000 Lekë
5.4. Në rast të konstatimit të therjeve të kafshëve të prodhimit jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Malësi e Madhe.	Hera 1: 10 000 Lekë
	Hera 2: 20 000 Lekë
	Për raste të përsëritura deri në konfiskimin të kafshës

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e gjobave: Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

Struktura për vendosjen e gjobave: Struktura për vendosjen e gjobave administrative janë inspektorët e sektoreve përkatës si dhe Policia e Bashkiake.

Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Sektorët e Bashkisë Malësi e Madhe.

III. 2. Gjobat për mos shlyrjen në afat të detyrimit.

Baza ligjore: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave Vendore” i ndryshuar; Ligji nr.164/ 2014, datë 4.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114/1, neni 127; Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”, neni 6, pika b.

Gjobat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT). Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 20 qershor e po këtij viti. Baza e llogaritjes së gjobës për mos shlyerje përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e shërbimeve, taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës, taksa e truallit, etj., sipas faturës për pagesë.

Niveli i gjobave për mosshlyrje në afat të detyrimit: Niveli i gjobave për mosshlyrje në afat të detyrimit (taksa, tarifa) paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 24: Niveli i gjobave për mosshlyrje në afat të detyrimit:

Nr.	Emertimi	Njësia	Tarifa
1.	Gjopa për mos shlyerje të detyrimeve tatimore Brenda afatit 20 prill. Gjopa për mosshlyerjen e detyrimeve tatimore deri në 30 ditë pas datës së regjistrimit për subjektet e reja ose ato që hapin adresa sekondare pas datës 20 prill.	Lekë \ për çdo kundravajtje.	Për çdo ditë vonesë 0.06% e vlerës së detyrimit të papaguar (maksimumi 21.9%)
2.	Gjobat nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.		
a.	Për moslejim në ushtrimin e kontrollit të inspektorve të taksave në ambjentet e biznesit.	Lekë \ për kundravajtje	100,000
b.	Për mosafishim i çmimeve të shitjes.	Lekë \ për kundravajtje	50,000
c.	Për mosmbajtjen e saktë të librave, rregjistratve dhe dokumentacionit.	Lekë \ për kundravajtje	10,000

Shënim:

a) Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat deri në 20 qershor për shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 20 qershor, afati i fundit për shlyerjen detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së regjistrimit.

b) Tatimpaguesi detyrohet të paguajë një gjobë apo kamatvonesë, të barabartë me 0,06 % (për qind) të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura për vendosjen e gjobave: Struktura për vendosjen e gjobave administrative janë inspektorët e sektorëve përkatës si dhe Policia e Bashkiake.

Ngarkohet sektori i taksave dhe tarifave vendore, për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre tarifave nga personat fizik, juridik si dhe institucionet që kanë detyrimin për të paguar.

Kapitulli IV: LEHTËSIRA FISKALE

Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 35 pika 3; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2010 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 21, pika 5 germa a dhe b; Ligji nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar” i ndryshuar, neni 13, ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, neni 16.

a. Përjashtime nga pagesa e Tarifes Familjare: Në tarifën nga cilat bëhen përjashtime për Tarifën Familjare përfshihen:

1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë “Familje”.
2. Tarifa e shërbimeve publike “ndriçim dhe gjelbërim” Për kategorinë “Familje”.

b. Kategoritë e përjashtuar nga pagesa e tarifës: Të gjitha kategoritë e mëposhtme:

1. Invalidët e punës (kryefamiljarë) me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë (përveç bashkëshortit, bashkëshortes).
2. Veteranët e Luftës Anti-Fashiste Nacional Çlirimtare (kryefamiljarë) me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë (përveç bashkëshortit, bashkëshortes).
3. Kryefamiljarë pensionista me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë (përveç bashkëshortit, bashkëshortes).
4. Grate kryefamiljare me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë (përveç fëmijë nën 22 vjeç student).
5. Për kategorinë “Familje” që kanë në përbërje të certifikatës familjare persona me aftësi të kufizuar (paraplegjikë, tetraplegjikë, të verbërit) do të tarifohen në masën -30 % (tridhjetë përqind më pak) të tarifës familjare.

c. Këto kategori duhet të paraqesin pranë Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore të Njësisë Administrative, dëshminë e gjendjes së tyre dhe më konkretisht:

- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës,
- Statusin e invalidit të punës,
- Statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë,
- Statusin e të përndjekurve politik.
- Vërtetimin nga Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike pranë Bashkisë ose të Njësisë Administrative si përfitues të ndihmës ekonomike.
- Certifikatën familjare.

Struktura e ngarkuar për verifikimin e familjeve që përfitojnë lehtësime fiskale: Struktura e ngarkuar për verifikimin e familjeve që përfitojnë lehtësime fiskale janë Zyra e Gjendjes Civile, Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike dhe Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore.

Kapitulli V: ANKIMI

Baza ligjore: Ligji nr. 9920 dt 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin 164\ 2014 neni 18, neni 38, neni 92; Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, të ndryshuar, neni 3.

- Çdo taksapagues ka të drejte të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vlerësuar detyrimet e tij nga zyrat e taksave, të kërkojë rimbursime si dhe të apeloje kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat përkatëse në Bashkinë Malësi e Madhe.
- Ankimi paraqitet me shkrim të strukturat vendore të apelimit tatimor, sipas kriterëve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për aktin administrative.

Ky ankimim në përputhje me Ligjin “Për Proçedurat Tatimore” duhet të përmbajë:

- a) Emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit;
- b) Vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi;
- c) Natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
- d) Baza ku mbështetet apelimi.

Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrativ.

Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në Projekt-ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore” dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij. Strukturat vendore të apelimit tatimore shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Kundër vendimit të strukturës vendore të apelimit tatimore, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatë. Ankimimi bëhet brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes në dijeni për vendimin e mësipërm.

Efektet financiare të paketës fiskale fillojnë me datë 01.01.2021.

KRYETAR

TONIN MARINAJ